



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



TARËH: DATE/A:	30.06.2022
REFERANS:REFERENC-Ë:	ZKF/069-22
KËME/PËR/ZA/TO:	z.Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC:	z. Hekuran Murati, Ministër Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
KËMINËNERËSIË/PËRMES/ PREKO/THROUGH:	Abdüladi Krasniç, Kryetar i Komunës së Mamushës
KËMDEN/NGA/OD/FROM:	Xhevahire Rushiti, Zyrtar Kryesor Financiar, Komuna e Mamushës
KONU/TEMA/SUBJKAT/SUBJEKT:	Korniza Afatmesme e Buxhetit për vitet 2023-2025

Të nderuar,

Në bazë të QB 2023/01 dhe kërkesave tona si Institucion, keni të bashkangjitur vlerësimet e proqesit buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore vitet 2023-2025.

Dokumentet e bashkangjitura;

1. Shkresa përcjellëse;
2. Vendimi i Asambles Komunale;
3. Dokumenti/Korniza Afatmesme e Buxhetit për vitet 2023-2025;

Shpenzimet rrejedhëse:

Paga dhe shtesa:

Sipas burimit të të hyrave me Qarkorën Buxhetore 2023/01 për kategorin paga dhe shtesa në bazë të kalkulimeve detale dhe burimit të të hyrave për vitin 2023 kjo është e mundur pasi që Komuna e Mamushës me parashikimin e buxhetit për vitin 2023 totali i të hyrave është për këtë kategori ekonomike duke i kalkuluar pagën bazë dhe të gjitha shtesat përcjellëse ka parashikuar shpenzimin vjetor për vitin 2023 në shumën prej 1,232,044.00€.

Mallra dhe Shërbime:

Kjo kategori ekonomike ka një rritje prej 10,000.00€ pasi duke e bazuar në rritjen e çmimeve të tregut në vitin 2022 për procedura të cilat kemi kontraktuar dhe vërejm që ka ndryshim krahasuar me vitet e kaluara dhe plani për këtë kategori në vitin 2023 është në shumën prej 337,000.00€.

Shpenzime Komunale:

Kjo kategori ekonomike do të mbetet e njëjtë sikurse në vitin 2022.

Subvencione dhe Transfere:

Për këtë kategori ekonomike parashikohet që të ketë rritje pasi që sipas rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duhet të i largojmë keqklasifikimet dhe me planin e buxhetit për vitin 2023 kjo kategori përfshin kërkesat komunale në shumën prej 86,000.00€.

Shpenzime Kapitale:

Kjo kategori sipas kërkesave dhe të hyrat komunale parashikohet të jetë në shumën prej 590,176.00€.

Stafi për vitin 2023 duhet të ketë rritje prej 21 tek arsimit për ti plotësuar politikat në vazhdim dhe politikat e reja dhe në arsimin parafillor 5 programi 92470, në arsimin fillor 65 programi 93390 dhe në arsimin e mesëm 18 programi 94590, pra gjithsejt stafi mësimdhënës, staf administrativ dhe personel ndihmës në vitin 2023 duhet të jetë 88 sipas Qarkorës Buxhetore 2023/01 nga të dhënat e Gratit për Arsim.

Pra total stafi për vitin 2023 duhet të jetë 176 në administratën komunale 60 , arsim 88 dhe shëndetësi 28.

Komuna e Mamushës



Pjesë të dokumentit KAB 2023-2025

Kategoria ekonomike (10+21)	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Paga dhe mëditjet	1,232,044.00	1,243,601.00	1,250,037.00
Mallrat dhe Shërbime	337,000.00	345,000.00	345,833.00
Shpenzimet komunale	31,000.00	31,000.00	31,000.00
Subvencionet dhe transferet	86,000.00	90,000.00	94,000.00
Shpenzimet kapitale	590,176.00	722,398.00	817,005.00
Total Shpenzimet	2,276,220.00	2,431,999.00	2,537,875.00

Grantet/Burimi	Viti 2023 QB 2023/01	Viti 2024 QB 2023/01	Viti 2022 QB 2023/01
Granti i Përgjithshëm	1,344,871.00	1,433,254.00	1,519,712.00
Granti për Arsim	612,659.00	665,054.00	668,582.00
Granti për Shëndetësi	248,271.00	260,685.00	273,719.00
Të Hyrat Vetanake	70,419.00	73,006.00	75,862.00
Total:	2,276,220.00	2,431,999.00	2,537,875.00

• **Limitet e shpenzimeve dhe burimet e financimit për vitin 2023**

Grantet/Burimi QB1/2023	Vlerësimi Viti 2023	Kerkesa 2023	Diferenca
Granti i Përgjithshëm	1,344,871.00	1,327,256.00	(17,615.00)
Granti për Arsim	612,659.00	612,659.00	-
Granti për Shëndetësi	248,271.00	265,886.00	17,615.00
Të Hyrat Vetanake	70,419.00	70,419.00	-
Total A	2,276,220.00	2,276,220.00	-
Limitet e shpenzimeve 2023	Plani Viti 2023	Kerkesa Viti 2023	Diferenca
Paga dhe Mëditje	1,232,044.00	1,232,044.00	-
Mallra dhe Shërbime	337,000.00	337,000.00	-
Shpenzime Komunale	31,000.00	31,000.00	-
Subvencione dhe transferë	86,000.00	86,000.00	-
Shpenzime Kapitale	590,176.00	590,176.00	-
Total B	2,276,220.00	2,276,220.00	-

• **Limitet e shpenzimeve dhe burimet e financimit për vitin 2024**

Grantet/Burimi QB1/2023	Vlerësimi Viti 2024	Kerkesa 2024	Diferenca
Granti i Përgjithshëm	1,433,254.00	1,423,053.00	(10,201.00)
Granti për Arsim	665,054.00	665,054.00	-
Granti për Shëndetësi	260,685.00	270,886.00	10,201.00
Të Hyrat Vetanake	73,006.00	73,006.00	-
Total A	2,431,999.00	2,431,999.00	-
Limitet e shpenzimeve 2024	Plani Viti 2024	Kerkesa Viti 2024	Diferenca
Paga dhe Mëditje	1,243,601.00	1,243,601.00	-
Mallra dhe Shërbime	345,000.00	345,000.00	-
Shpenzime Komunale	31,000.00	31,000.00	-
Subvencione dhe transferë	90,000.00	90,000.00	-
Shpenzime Kapitale	722,398.00	722,398.00	-
Total B	2,431,999.00	2,431,999.00	-

- Limitet e shpenzimeve dhe burimet e financimit për vitin 2025

Grantet/Burimi QB1/2023	Vlerësimi Viti 2025	Kerkesa 2025	Diferenca
Granti i Përgjithshëm	1,519,712.00	1,519,712.00	-
Granti për Arsim	668,582.00	668,582.00	-
Granti për Shëndetësi	273,719.00	273,719.00	-
Të Hyrat Vetanake	75,862.00	75,862.00	-
Total A	2,537,875.00	2,537,875.00	-
Limitet e shpenzimeve 2025	Plani Viti 2025	Kerkesa Viti 2025	Diferenca
Paga dhe Meditje	1,250,037.00	1,250,037.00	-
Mallra dhe Shërbime	345,833.00	345,833.00	-
Shpenzime Komunale	31,000.00	31,000.00	-
Subvencione dhe transfere	94,000.00	94,000.00	-
Shpenzime Kapitale	817,005.00	817,005.00	-
Total B	2,537,875.00	2,537,875.00	-

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin Tuaj.

Me respekt,



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01. Nr. 015-22
Më 30.06.2022
Mamushë

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048 neni 20, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni 40. al2. pika b), neni 18.4 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës së Mamushës bje këtë:

V E N D I M

Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025

Neni 1

Në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2022, Kuvendi i Komunës së Mamushës, ka aprovuar **Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2023 – 2025**, sipas Qarkores Buxhetore nr. 2023/01 dhe propozimeve nga ekzekutivi. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesët: Kryetari i Komunës, Asambleja Komunale dhe Drejtorit përkatëse.

Kategoria ekonomike (10+21)	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Paga dhe mëditjet	1,232,044.00	1,243,601.00	1,250,037.00
Mallrat dhe Shërbime	337,000.00	345,000.00	345,833.00
Shpenzimet komunale	31,000.00	31,000.00	31,000.00
Subvencionet dhe transferet	86,000.00	90,000.00	94,000.00
Shpenzimet kapitale	590,176.00	722,398.00	817,005.00
Total Shpenzimet	2,276,220.00	2,431,999.00	2,537,875.00

Grantet/Burimi	Viti 2023 QB 2023/01	Viti 2024 QB 2023/01	Viti 2022 QB 2023/01
Granti i Përgjithshëm	1,344,871.00	1,433,254.00	1,519,712.00
Granti për Arsim	612,659.00	665,054.00	668,582.00
Granti për Shëndetësi	248,271.00	260,685.00	273,719.00
Të Hyrat Vetanake	70,419.00	73,006.00	75,862.00
Total:	2,276,220.00	2,431,999.00	2,537,875.00

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit të tij në Asamblen Komunale.

Me këtë vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Të gjitha drejtorit
- Departamenti i Buxhetit Komunal – MFPT
- Arkivi

Kryesues i Kuvendit të Komunës
Necmedin Morina



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
PËR VITET 2023-2025

Qershor, 2022

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2023-2025

3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjes dhe Financimi i Jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2023-2025

3.6. Analiza Gjinore

IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve


V. Informacionet sipas programeve

I. Hyrje

Plani i buxhetit për vitet 2023-2025, që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2023/01 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjigjesite (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2023-2025. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Deklarata e Prioriteteve 2023-2025 nga Strategjia Zhilimore Komunale

Mamusha është një fshat që i përkiste Komunës së Prizrenit deri në vitin 2005 kur ajo u krijua si një pilot komunë. Komuna e Mamushës është një komunë e vogël rurale në jug të Kosovës. Ajo kohët e fundit fitoi statusin si një qendër administrative dhe komunë, por ka funksionuar si një komunitet rural lokal që nga viti 1985.

Mamusha ka filluar të funksionojë si një pilot komunë në vitin 2005, pas nxjerrjes së një akti administrativ nga përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Pilot Komunës i ishte dhënë statusi i plotë në vitin 2008 pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe kufijtë administrative të Komunës. Vendbanimi linear është i vendosur në një pjerrtësi në qendër të komunës, përgjatë një rrugë të ngushtë dhe gjarpëruese. Sipërfaqja e saj është 10.94 km² dhe është njëra nga njësitë komunale më të vogla në Kosovë. Koordinatat e komunës janë gjerësia 42° 20' 40" dhe gjatësi 20° 43' 47". Komuna në juglindje kufizohet me Komunën e Prizrenit, në verilindje me Komunën e Suharekës dhe në veriperëndim me Komunën e Rahovecit. Vendbanimi i vetëm në komunë është e komuna e Mamushës që gjendet në të dy anët e rrugës që lidh rrugën Piranë – Suharekë me rrugët regjionale Prizren-Prishtinë dhe Prizren – Shkup, ndërsa në jug lidh me Gjakovën dhe Pejën. Distanca nga qendrat e komunave qinje është: nga Prizreni është 20 km, nga Suhareka është 10 km dhe nga Rahoveci 15 km.

Regjistrimi i fundit i popullatës ishte bërë më 2011, për herë të parë për Mamushën si një komunë në vetë. Në mënyrë që të krijohet një ide e evoluimit të vendbanimeve në kuptimin e rritjes së popullatës ndër vite, në tabelën e mëposhtme janë prezantuar të dhëna nga viti 1945 deri më 2011.

Megjithatë, siç tregon tabela ka një rritje konstante të popullsisë. Nga të dhënat në tabelën 1. Popullata prej vitit 1948-1953 është rritur për 11% (përafërsisht 2.2% në vit), nga vitet 1953-1961 është rritur 6% (ose përafërsisht 0.75% në vit), nga 1961-1971 është rritur për 28% (ose përafërsisht 2.8% në vit), nga viti 1971-1981 është rritur 35% (përafërsisht 3.5% në vit) dhe prej vitit 1981-1991 popullata është rritur për 20% (përafërsisht 2% në vit). Megjithatë, nga viti 1991 deri në vitin 2011 numri i popullatës është shtuar për 67% (ose 3.35% në vit). Nga të dhënat e mësipërme mund të shihet se rritja më e madhe e popullsisë ishte në periudhën mes viteve 1991-2011.

Tabela 1. Rritja e popullsisë ndër vite

Popullsia e komunës së Mamushës								
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2010	2011
Nr. banorve	1.352	1.500	1.590	2.038	2.752	3.297	4.234	5.507

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të komunës së Mamushës është 10.94 km² me dendësi të popullatës prej 503.4 banorë në /km² (e llogaritur për numrin e popullatës të nxjerrë nga Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë më 2011). Kjo shifër tregon se dendësia e popullatës në Mamushë është më e lartë se dendësia mesatare në Kosovë, që është (177.4 banorë /km²).

Tabela 2. Numri i ekonomive familjare

Ekonomite familjare në komunën e Mamushës								
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2008	2011
Ekonom. familjare	183	198	209	220	263	334	403	566

- Situatat socio-ekonomike

✓ Punësimi dhe papunësia

Në komunën e Mamushës numri i përgjithshëm i popullsisë në moshë pune (15 deri 64 vjet) është rreth 3440, numri i popullatës ekonomikisht aktive është rreth 1216, prej të cilëve 97% janë të punësuar, 1.1% ka punuar por tash është e papunë, 0.7% e papunë dhe nuk ka punuar kurrë, 0.9% e papunë duke pritur që të fillojë punën, përdërisa numri i popullatës ekonomikisht jo aktive është rreth 2224 apo 65% e numrit të përgjithshëm të moshës së punës.

Janë të regjistruara 134 biznese dhe prej tyre 76 janë aktive që operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën Mamushës, prej bizneseve që janë aktive dhe 95% merren me veprimtari regjare, 1% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 2% në prodhimtari.

Administrimi aktual i komunës përbëhet nga zyra e kryetarit dhe tetë drejtorive komunale dhe sektorët e tyre të ndërlidhura.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Mamushës i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2024 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetëve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2023/1 të lëshuar nga ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Mamushës është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrimtë një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attribute binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe contribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Mamushës:

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rinë dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

1. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë. Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2023-2025 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2025 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 e Qeverisë së Kosovës, situata e krijuar nga pandemia COVID-19, ka shtyrë që prioritet e qeverisë të drejtohen drejt tejkalimit të krizës dhe rimëkëmbjes ekonomike. Sipas projeksioneve të fundit të azhurnuara nga MFPT-ja, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2022 pritet që të shënojë rritje nominale prej 12.0% ndërsa në terma realë me rreth 5.7%.¹⁾

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të ulet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë. Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komuna po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e ruamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Mamushës në periudhën afatmesme buxhetore 2023-2025 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka ejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 3: Indikatorët ekonomik komunal


Pëshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024	2025
	Aktuale	Aktuale	Vlerësim	Vlerësim	Vlerësim	Vlerësim
Parashikimi makroekonomik sipas KASH-it 2023-2025						
Rritja reale e BPV në %	-5.3	9.1	3.9	4.3	4.2	n/a
<i>Sipas Banka Botërore (Prill 2022)</i>						
Inflacioni në %						
BPV për kokë banori, në euro	6,772.00	7,637.00	8,568.00	9,212.00	9,815.00	10,400.00
<i>Në milion euro (vlera nominale)-sipas FMN prill 2022</i>						
Indikatorët ekonomik komunal						
Popullsia e Komunës	5507	6500	6500	6600	6600	6700
Numri i bizneseve të regjistruara në Mamushë	76	76	76	80	85	100
Numri i nxënësve	946	898	936	925	950	970

¹⁾ Burimi i informatave për tabelën 3: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2023-2025.

3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afat-mesëm 2023-2025

Të hyrat e Komunës së Mamushës nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje dhe ulje nga viti 2020 deri në vitin 2025.

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite , milion Euro:



Viti 2020	2,358,481.12
Viti 2021	1,763,941.85
Viti 2022	1,802,039.00
Viti 2023	2,276,220.00
Viti 2024	2,431,999.00
Viti 2025	2,537,875.00

Në bazë të planifikimit nga viti 2020-2025, grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake për Komunën e Mamushës, si tërësi do të shënojnë ulje përgjatë vitit 2021. Ku në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 kemi ulje për 25%, në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje të ulët për 2% ndërsa në planin e të hyrave totale në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 kemi një rritje prej 26%.

Sipas Tabelës 5: Shpërndarja e grantit specifik për arsim, për vitin 2023-2025 e këtijë granti sipas QB 01/2023 *tabela Shpërndarja e grantit specifik për arsim, granti bazë për vitin 2023-2025*, ka siguruar që është përfshir formula për logaritjen e tijë si krahasim me numrin e nxënësve ku janë të paraqitur 925 nxënës dhe numri i stafit për arsimin parafillor, fillor të mesëm është 88 dhe në realitet në ligjin e buxhetit për vitin 2022 sipas tabelës 4.1 numri stafi në arsim është 67 dhe në këtë rast është diferenca e stafit prej 21 dhe për këtë ne detyrohemi të blejm shërbime për të punsuar staf në arsim për të arritur normën e plotë për mësim duke u munduar për të plotësuar të gjitha politikat në arsimin parauniversitar. Sipas QB 01/2023 në planin e stafit në arsim në Komunën e Mamushës duhet të plotësohet stafi prej 21 dhe me këtë do të ju sigurojmë që diferenca e rritjes për Grantin Specifik të Arsimit në kategorin paga dhe shtesa do të etë reale dhe objektive.

Rritja e granteve qeveritare si total i të gjitha burimeve/granteve për vitin 2023 do të jetë për 26% më e lartë në krahasim me vitin 2022. Në këtë dokument duhet të theksohet sipas Granti specifik për Shëndetësi primare, granti bazë për vitin 2023-2025 në QB 01/2023 tek kjo table figuron sipas shënimeve nga Ministria e Shëndetësisë që Komuna e Mamushës ka QKMF një object dhe në realitet ne si Institucion kemi vetëm një objekt të QMF-ës dhe në këtë rastë duhet të bëhet përmirësimi tek shënimet për Grantin Specifik të Shëndetësisë.

Shpenzimet rrejedhëse:

Paga dhe shtesa:

Në Qarkorën 2023/01 për kategorin paga dhe shtesa në bazë të kalkulimeve detale dhe burimit të të hyrave për vitin 2023 kjo është e mundur pasi që Komuna e Mamushës me parashikimin e buxhetit për vitin 2023 totali i të hyrave është për këtë kategori ekonomike duke i kalkuluar pagën bazë dhe të gjitha shtesat përcjellëse ka parashikuar shpenzimin vjetor për vitin 2023 në shumën prej 1,232,044.00€.

Mallra dhe Shërbime:

Kjo kategori ekonomike ka një rritje prej 10,000.00€ pasi duke e bazuar në rritjen e çmimeve të tregut në vitin 2022 për procedura të cilat kemi kontraktuar dhe vërejm që ka ndryshim krahasuar me vitet e kaluar dhe plani për këtë kategori në vitin 2023 është në shumën prej 337,000.00€.

Shpenzime Komunale:

Kjo kategori ekonomike do të mbetet e njëjtë sikurse në vitin 2022.

Subvencione dhe Transfere:

Për këtë kategori ekonomike parashikohet që të ketë rritje pasi që sipas rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duhet të i largojmë keqklasifikimet dhe me planin e buxhetit për vitin 2023 kjo kategori përfshin kërkesat komunale në shumën prej 86,000.00€.

Shpenzime Kapitale:

Kjo kategori sipas kërkesave dhe të hyrat komunale parashikohet të jetë në shumën prej 590,176.00€.

Stafi për vitin 2023 duhet të ketë rritje prej 21 tek arsimi për ti plotësuar politikat në vazhdim dhe politikat e reja dhe në arsimin parafillor 5, në arsimin fillor 65 dhe në arsimin e mesëm 18, pra gjithsejt stafi mësimdhënës, staf administrativ dhe personel ndihmës në vitin 2023 duhet të jetë 88 sipas Qarkorës Buxhetore 2023/01 nga të dhënat e Gratit për Arsim. Pra total stafi për vitin 2023 duhet të jetë 176 në administratën komunale, arsim dhe shëndetësi.

Tabela 4. Krahasimi i Të Hyrat Vetanake, plani, realizimi dhe krahasimi 2012-2022

Të Hyrat Vetanake	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Maj 2022
Plani	58,000.00	60,000.00	63,000.00	64,869.00	64,900.00	105,826.00	69,186.00	71,069.00	63,197.00	56,934.00	73,148.00
Realizimi	42,650.43	41,367.33	62,498.35	52,763.04	56,243.98	53,340.73	73,202.06	69,983.38	55,566.58	67,482.47	26,241.34
Krahasimi me planin %	74	69	99	81	87	50	106	98	87.93	118.53	35.87
Krahasimi i planit nga viti 2012-2022	86.16	103.45	105.00	102.97	100.05	163.06	65.38	102.72	88.92	90.09	128.48

Kalkulimet e Tatimit në Pronë:

- *Vlera e Patundshmërisë dhe Tokës*— sipas ndarjes së pronave në kategori zonave
- *Vlera e Kalkuluar Vjetore*— që duhet të mbledhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e Pagesës Vjetore*— Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i Akumuluar dhe Pagesa e Pritur e Borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

Kalkulimet e të hyrave tjera:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të Komunës janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe pagesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara.

Tabela 5. Krahasimi i të hyrave komunale, plani për vitin fiskal 2023-2025 me vitin aktual 2022

Grantet/Burimi	Plani Viti 2022	Vlerësimi Viti 2023	Vlerësimi Viti 2024	Vlerësimi Viti 2025	Diferenca 2023/2022	% 2023/2022
Granti i Përgjithshëm	1,048,114.00	1,344,871.00	1,433,254.00	1,519,712.00	296,757	128
Granti për Arsimin	482,626.00	612,659.00	665,054.00	668,582.00	130,033	127
Granti për Shëndetësi	198,151.00	248,271.00	260,685.00	273,719.00	50,120	125
Të Hyrat Vetanake	73,148.00	70,419.00	73,006.00	75,862.00	(2,729)	96
Total:	1,802,039	2,276,220	2,431,999	2,537,875	474,181.00	126




Tabela 6: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2023-2025, në Euro

	Komuna e Mamushës	Grantet dhe THV – 2022 (këtë vit) në Euro	Grantet dhe THV – 2023 (viti e 1) në Euro	Grantet dhe THV – 2024 (viti e 2) në Euro	Grantet dhe THV – 2025 (viti e 3) në Euro
	BURIMET E TË ARDHURAVE				
0	GRANTET	1,728,831.00	2,205,001.00	2,358,993.00	2,462,013.00
	Granti i Përgjithshëm	1,048,114.00	1,344,871.00	1,433,254.00	1,519,712.00
	Granti i Arsimit	482,626.00	612,659.00	665,054.00	668,582.00
	Granti i Shëndetësisë	198,151.00	248,271.00	260,685.00	273,719.00
	Buxhet Shtese				
I-A.					
1	Uçensat për lojra zbavitëse, pije alkoolike, reklamime, shpallje etj.				
	Funksionimet me makina me monedha ose me lojra dh të ngjajshme				
2	Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit				
	Lejet për ndërtim dhe konstruktive				
3	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike	7,500.00	7,500.00	8,000.00	7,500.00
	Përgatitja e plan.urban. dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	7,500.00	7,500.00	8,000.00	7,500.00
	Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit				
4	Shërbimet e Inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	3,430.00	3,430.00	3,430.00	3,430.00
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik				
	Inspektimi i ambientit (Mjeturinat)	3,430.00	3,430.00	3,430.00	3,430.00
	Inspektimi i ndërtimit, shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit				
5	Shfrytëzimi i pronës Komunale	1,222.00	-	-	-
	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	1,222.00	-	-	-
6	Pagesat në lidhje me Automjetet	8,500.00	7,193.00	9,000.00	8,500.00
	Lejet e automjeteve				
	Parkimi në parkingun publik i paisur me garazhim apo hapsira tjera				
	Regjistrimi i automjeteve	8,500.00	7,193.00	9,000.00	8,500.00
7	Certifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	5,200.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
	Dokum. lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes, vdekjes, martesës, shkurorizimit	5,200.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
	Të tjera				
8	Tatimi ne Prone	43,296.00	43,296.00	43,187.00	47,026.00
	Pagesat e tatimit ne prone	43,296.00	43,296.00	43,187.00	47,026.00
9	Të ardhurat tjera- Tax per biznesa	-	-	-	-
	Pagesat tjera- Tax per biznese	-	-	-	-
I-A.	Nëntotali I-A: Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	69,148.00	66,419.00	68,617.00	71,456.00
	Denimet në komunikacion, të grumbulluara përmes Nivellit Qendror (ShPK)				
	Gjoha te gjykatave				
I - B.	Nëntotali I-B: Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)				
I	Total i Administratës komunale (Direkte dhe indirekte e I-A+B)	69,148.00	66,419.00	69,006.00	71,862.00
	TË ARDHURAT NGA ARSIMI				
	Qerdhet				
	Mësimi joformal				
II	Total - Arsimit				
	TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA				
1	Shëndetësia primare	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
		-	-	-	-
III	Total - Shëndetësia	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
IV	Të tjera Planit QB 2023/01 dhe 2022/1 MF Tatimi ne toke dhe mbledhja e borjeve			389.00	406.00
Kodi 21	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES (I +II+III+IV)	73,148.00	70,419.00	73,006.00	75,862.00
	TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE	1,802,039.00	2,276,220.00	2,431,999.00	2,537,875.00

Komuna e Mamushës vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 97% të buxhetit total të komunës. *Vlen të theksohet se Të Hyrat Vetanake janë të planifikuara vetëm pagesat direkte, ndërsa pagesat indirekte janë plan i nivelit qendror.*

- Huamarrja

- Komuna e Mamushës nuk planifikon huamarrje për vitin fiskal 2023.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna Mamushës në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

